

# UDHËZUES MBI PJESËMARRJEN PUBLIKE NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË

Implementuar nga:

**UN HABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:

**SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION**



# UDHËZUES MBI PJESËMARRJEN PUBLIKE NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

Tetor 2014

PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË

*Implementuar nga:*

**UN HABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

*Financuar nga:*

**SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION**



## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>I. SFONDI</b> .....	<b>4</b>
1.1 HYRJE.....	4
1.2 QËLLIMI I UDHËZUESIT .....	4
1.3 LEGJISLACIONI KRYESOR LIDHUR ME PROCESIN E PJESËMARRJES PUBLIKE .....	4
<b>II. KONCEPTET</b> .....	<b>6</b>
2.1 ÇKA ËSHTË PJESËMARRJA PUBLIKE?.....	6
2.2 PSE PJESËMARRJA PUBLIKE?.....	6
2.3 INTEGRIMI I PJESËMARRJES NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR .....	7
2.4 NIVELET E PJESËMARRJES PUBLIKE NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR .....	8
2.4.1 INFORMIMI .....	10
2.4.2 KONSULTIMI .....	11
2.4.3 MARRJA E VENDIMEVE SË BASHKU .....	13
2.4.4 TË VEPRUARIT SË BASHKU .....	15
2.4.5 MBËSHTETJA E INICIATIVAVE LOKALE .....	16
<b>III. HAPAT E PËRGJITHSHËM PËR PJESËMARRJEN PUBLIKE</b> .....	<b>17</b>
3.1 HAPI 1: INICIMI DHE MENAXHIMI .....	17
3.2.1 IDENTIFIKONI AKTERËT DHE ROLET E TYRE .....	18
3.2.2 IDENTIFIKONI METODAT E DUHURA PËR TË INFORMUAR AKTERËT RRETH PROCESIT(VE) TË PJESËMARRJES PUBLIKE .....	18
3.2 HAPI2: PËRCAKTIMI I AKTERËVE/PALËVE TË INTERESIT TË CILËT DUHET TË PËRFSHIHEN NË PROCESIN E PJESËMARRJES PUBLIKE.....	18
3.3.1 IDENTIFIKONI LLOJIN (-ET) MË TË PËRSHTATSHËM TË PJESËMARRJES PUBLIKE QË DUHET TË PËRDORËT/APLIKOHET .....	19
3.3 HAPI 3: IDENTIFIKIMII LLOJEVE TË PJESËMARRJES .....	19
3.4.1 IDENTIFIKONI KAPACITETET E KËRKUARA PËR LEHTËSIMIN E PJESËMARRJES PUBLIKE 20	
3.4.2 IDENTIFIKONI AKTIVITETET DHE BURIMET E KËRKUARA PËR PJESËMARRJEN PUBLIKE 20	
3.4 HAPI 4: HARTIMI I PLANIT TË DETAJUAR TË VEPRIMIT .....	20
3.5.1 TË SIGUROJË ARANZHIME TË DUHURA LOGJISTIKE, TË TILLA SI: .....	21
3.6.1 INFORMONI TË GJITHË AKTERËT LIDHUR ME REZULTATIN E PROCESIT TË PJESËMARRJES PUBLIKE SI DHE PO ASHTU KTHENI PËRGJIGJE PËR PËRFSHIRJEN, APO JO, TË KOMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE TË TYRE NË DOKUMENTIN E PLANIFIKIMIT .....	21
3.5 HAPI 5: ZBATIMI I PROCESIT TË PJESËMARRJES PUBLIKE .....	21
3.6 HAPI 6: KTHIMI I PËRGJIGJEVE/SQARIMEVE PËR KOMENTET DHE REKOMANDIMET E AKTERËVE/PALËVE TË INTERESIT .....	21
3.7.1 SHQYRTONI PROCESËT DHE INICIATIVAT E PJESËMARRJES PUBLIKE .....	22
3.7 HAPI 7: VLERËSIMI DHE MONITORIMI.....	22
<b>IV. KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET</b> .....	<b>23</b>
4.1 ÇKA E KARAKTERIZON NJË PJESËMARRJE TË MIRË? .....	23
4.2 NATYRA E PJESËMARRJES EFEKTIVE .....	24
4.3 RREZIQET E MUNDSHME .....	24
4.4 SHEMBUJ TË SFIDAVE DHE ZGJIDHJEVE MË TË SHPESHTA .....	25
<b>V. REFERENCAT:</b> .....	<b>27</b>
SHTOJCA I. NIVELET E PJESËMARRJES PUBLIKE .....	28
SHTOJCA II. SHEMBULL: KORNIZA KOHORE E KONSULTIMEVE PËR PLANIN HAPËSINOR.....	32
SHTOJCA III. SHEMBULL I: MATRICA E STRUKTURËS SË NDARJES SË PUNËS PËR ORGANIZIMIN E DISKUTIMIT PUBLIK.....	33

SHTOJCA IV. SHEMBULL: SHABLLONI I MATRICËS SË AKTIVITETT/PËRGJEGJËSIVE .....	34
SHTOJCA V. SHEMBULL I PYETËSORIT TË VLERËSIMIT .....	35
Foto 1. Përfshirja e komunitetit në anketim për Junikun, PZHK.....	6
Foto 2. Shënimi i DBH në Prizren.....	6
Foto 3. Vizioni komunal nga fëmijët për .....	6
Foto 4. Punëtorja e vizionimit për komunën e Graçanicës.....	6
Foto 5. Prezantimi publik i vizionimit të Malishevës .....	10
Foto 6. Diskutime në prezantimin publik të vizionimit të Malishevës .....	11
Foto 7. Punëtorja e dizajnit për rregullimin e parkut të Moronicës, PIK në Junik.....	13
Foto 8. Grupet e ndryshme etnike duke planifikuar së bashku mjedisin e jashtëm të shkollës e Radevës / Komuna e Graçanicës.....	15
Figura 1. Akterët në planifikimin hapësinor.....	8
Figura 2. Vazhdimësia e pjesëmarrjes-Llojet e pjesëmarrjes .....	9
Figura 3. Matrica e interesit-ndikimit.....	18

# I. SFONDI

## 1.1 HYRJE

Një aspekt i rëndësishëm i procesit të formimit të demokracive të reja në Evropën Lindore përfaqësohet nga zhvendosja e pushtetit nga proceset e planifikimit të centralizuar drejt një sistemi më të decentralizuar, i cili ngërthen një sistem gjithëpërfshirës të pjesëmarrjes publike.

Pjesëmarrja e publikut rrjedh nga dispozitat që kanë të bëjnë me të drejtat civile dhe në veçanti të drejtën për të marrë pjesë, për t'u informuar, për t'u dëgjuar, dhe për të shprehur opinionin dhe komentet. Me miratimin dhe nënshkrimin e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, qeveritë zotohen të respektojnë këto të drejta dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

Të drejtat për pjesëmarrje në procesin e planifikimit, qasja në informacion dhe e shprehjes së opinionit është reflektuar edhe në Ligjin për Planifikimin Hapësinor, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2013. Ky është aspekti ligjor i pjesëmarrjes publike, por jo e vetmja arsye pse grupe të ndryshme të palëve të interesit, përfshirë shoqërinë civile dhe qytetarët në përgjithësi, duhet të përfshihen në procesin e planifikimit. Planifikimi i zhvillimit lokal, shfrytëzimi i tokës, krijimi i rendit hapësinor, ofrimi i shërbimeve publike dhe krijimi i vendeve të reja të punës bëhet me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës së qytetarëve.

## 1.2 QËLLIMI I UDHËZUESIT

Udhëzuesi për përfshirjen e shoqërisë civile dhe të gjitha palëve të tjera përkatëse të interesit në procesin e planifikimit hapësinor, ka në fokus kryesisht anëtarët e organeve qeveritare të nivelit qendror dhe lokal të cilët do të jenë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor në mënyrë pjesëmarrëse, përfshirëse dhe të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore. Ai ka për qëllim edhe rritjen e njohurive dhe kapaciteteve të atyre që punojnë në fushën e qeverisjes urbane dhe planifikimin e qytetit duke përmirësuar dhe duke ndihmuar për të institucionalizuar qasje të tilla pjesëmarrëse.

Udhëzuesi gjithashtu mund të shërbejë si një burim i informatave për akterët tjerë relevant. Ai është pjesë e një dokumenti më të gjerë që ka të bëjë me kërkesat ligjore të dokumenteve të planifikimit hapësinor, siç përcaktohet në Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe aktet përcjellëse nënligjore. Qëllimi është që ky Udhëzues të jetë sa më praktik, por edhe të paraqesë disa teori bazë që mund të jenë të dobishme për ata që nuk kanë pasur mundësi më parë të punojnë lidhur me çështjet e pjesëmarrjes publike.

## 1.3 LEGJISLACIONI KRYESOR LIDHUR ME PROCESIN E PJESËMARRJES PUBLIKE

Pjesëmarrja publike si një e drejtë demokratike e njeriut e garantuar me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, është e garantuar po ashtu edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kushtetuta parashih zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe instrumenteve për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore (neni 22).

Ligji për Planifikimin Hapësinor nr.04/L-174 parashih pjesëmarrjen e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor (neni 20). Për më tepër, Udhëzimi Administrativ Nr.05/2014 për "Përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e

Udhëzues për pjesëmarrjen publike në planifikimin hapësinor

publikut në planifikimin hapësinor" parashih në mënyrë më të detajuar procedurat e pjesëmarrjes, përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor dhe parimet për organizimin e prezantimeve, shqyrtimeve publike si dhe të gjitha format tjera të pjesëmarrjes publike që nga fillimi dhe gjatë të gjitha fazave të proceseve të planifikimit hapësinor.

Të gjitha këto instrumente ligjore krijojnë një bazë për inkurajimin e mëtutjeshëm dhe fuqizimin e përfshirjes së publikut në proceset e vendim-marrjes së planifikimit hapësinor.

## II. KONCEPTET

### 2.1 ÇKA ËSHTË Pjesëmarrja Publike?

Pjesëmarrja publike është përfshirja aktive e qytetarëve në jetën ekonomike, sociale dhe politike të një vendi (rajoni, komuniteti), gjë që siguron se përfituesit janë pjesëmarrës efektiv në vendimet kolektive në lidhje me të mirën e përbashkët (Plani i Veprimit Vancouver - qershor 1976).

Foto 1. Përfshirja e komunitetit në anketim për Junikun, PZHK



Burimi: UN-Habitat MuSPP

*“Më thuaj, do të harroj;  
Më trego, mund të më kujtohet;  
Më përfshij dhe do ta kuptoj”  
Fjalë e urtë kineze*

Foto 2. Shënimi i DBH në Prizren



Burimi: UN-Habitat MuSPP

Foto 3. Vizioni komunal nga fëmijët për PZHK-në e Junikut



Foto 4. Punëtorja e vizionimit për komunën e Graçanicës



### 2.2 PSE Pjesëmarrja Publike?

- Shpien në rezultate që pasqyrojnë më mirë nevojat dhe pikëpamjet e komunitetit të gjerë;

Udhëzues për pjesëmarrjen publike në planifikimin hapësinor

- Përmirëson cilësinë dhe efikasitetin e vendimeve duke u mbështetur në njohuritë lokale dhe zvogëlon konfliktet e panevojshme;
- Paraqet një mjet për të arritur demokracinë e hapur pjesëmarrëse;
- Ndihmon ndërtimin e konsensusit për nismat zhvillimore, veçanërisht në kontekstin e kërkesave të mëdha, burimeve të kufizuara dhe kapacitetit të kufizuar;
- Rrit efikasitetin e investimeve zhvillimore, duke u mbështetur në burimet lokale dhe aftësitë e menaxhimit të inputeve nga jashtë nëpërmjet përfshirjes së të gjithë akterëve të mundshëm në identifikimin, hartimin dhe monitorimin e projekteve;
- Rrit efektivitetin e investimeve zhvillimore pasi që bazohet në njohuritë lokale dhe të kuptuarit e problemeve, duke drejtuar kah ndërhyrjet më të mira dhe të përshtatura;
- Zgjeron kapacitetet njerëzore lokale pasi që ata mësojnë të menaxhojnë dhe negociojnë aktivitetet zhvillimore;
- Potencialisht rrit përfshirjen pasi që qytetarët lokal marrin përgjegjësinë për qëndrueshmërinë e vazhdueshme dhe ndërhyrjet e mundshme;
- Shpien në iniciativa më gjithëpërfshirëse pasi që përmirëson mundësinë e përfshirjes së grave dhe grupeve tjera të diskriminuara.

## 2.3 INTEGRIMI I PJESËMARRJES NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

Pjesëmarrja e publikut në proceset e vendimmarrjes, përfshirë planifikimin hapësinor, shihet si një element i rëndësishëm në zhvillimin e strategjive për zgjidhjen e problemeve urbane. Kjo mund të lidhet me çështje të tilla si përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve lokale, zbutjen e varfërisë, përmirësimin e mjedisit urban, zhvillimin ekonomik, përmirësimin e standardeve të sigurisë për fëmijët dhe gratë në zonat urbane, dhe shumë çështje të tjera.

Përfshirja e qytetarëve në identifikimin e nevojave të tyre, përzgjedhjen e prioriteteve dhe identifikimin e strategjive ofron një shans më të mirë për zhvillimin e zgjidhjeve të cilat janë të qëndrueshme, të realizueshme dhe në zbatimin e të cilave qytetarët janë të gatshëm të ndihmojnë. Ka shumë mjete të ndryshme të cilat mund të përdoren për të nxjerrë pikëpamjet dhe opinionet e qytetarëve, për të "matur" gatishmërinë e tyre për pjesëmarrje, dhe në fund për të mobilizuar pjesëmarrjen e tyre. Një nga gjërat më të rëndësishme në lidhje me përfshirjen e publikut në këtë proces është të kuptuarit e interesave, nivelit të ndikimit dhe kapaciteteve për pjesëmarrjen e të gjithë akterëve.


Një nga arsytet se pse qeveritë lokale janë gjithnjë e më të hapura ndaj pjesëmarrjes së publikut është njohja e potencialit vendor ofruar nga institucionet jo-qeveritare, komuniteti i biznesit, shoqëria civile në përgjithësi, si dhe akterët tjerë, si një mjet për përgatitje dhe zbatim më të mirë dhe më efikas të projekteve zhvillimore. Për shembull, ndërtimi i partneritetit me komunitetet lokale, që i ekspozohen rrezikut dhe që kanë njohuri të detajuar se si rreziqet natyrore kanë ndikuar në lagjet e tyre, mundëson një reagim më të mirë ndaj këtyre rreziqeve.

Duke marrë iniciativën për të futur në drejtimin e duhur pjesëmarrjen publike, qeveritë qendrore dhe lokale mund të jenë të përgatitura më mirë për të hapur një dialog konstruktiv me qytetarët. Përvoja tregon se në qoftë se kjo nuk është bërë në kohën e duhur, shoqëria civile do të kërkojë angazhimin e saj gjithsesi, por shpesh duke marrë një pozitë më të fuqishme dhe konfrontuese.



Ka disa argumente kundër përfshirjes së gjerë të qytetarëve në planifikimin hapësinor, të tilla si mungesa e interesimit dhe e kapaciteteve të qytetarëve për të kontribuar në mënyrë kreative, kosto më e lartë dhe kohëzgjatje më e madhe për t'i marrë vendimet. Megjithatë, ka edhe përfitime të qarta dhe të dëshmuara mirë. Këto përfshijnë pronësinë më të madhe lokale dhe ndjenjën e përgjegjësisë për idetë, zhvillimin e tolerancës dhe të bashkëpunimit mes grupeve të ndryshme sociale, duke siguruar përgjigje më të mirë ndaj nevojave lokale si dhe angazhim më të fuqishëm për të marrë pjesë në zbatimin dhe mirëmbajtjen e projekteve të zhvilluara.

Figura 1. Akterët në planifikimin hapësinor



(Burimi: Adaptuar nga prezantimi MuSP në Forumin Botëror Urban në Napoli më 6 / UN-Habitat)

Akterët/palët e interesit në procesin e planifikimit hapësinor përfshijnë politikanë, zyrtarë qeveritarë në nivel qendror dhe lokal, aktivistë, qytetarë, komunitetin e biznesit, organizatat lokale, grupet formale dhe joformale, mediat - burra dhe gra të moshave të ndryshme dhe të statusit të ndryshëm social, grupet etnike dhe arsimore.

## 2.4 NIVELET E PJESËMARRJES PUBLIKE NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR


Shkalla e pjesëmarrjes publike shpesh paraqitet në formën e një shkallë e cila varion nga pranimi i zgjidhjeve nga qytetarët, të cilat tashmë janë bërë pa pjesëmarrjen e tyre, deri në kontrollin e plotë të qytetarëve për projektet e hartuara dhe të zbatuara nga ana e tyre. Koncepti i shkallëve është zhvilluar fillimisht nga Sherry Arnstein dhe citohet shpesh si bazë për ndryshime të mëtejshme të kërkuara nga programet apo projektet e veçanta.

Nivelet e pjesëmarrjes të përcaktuara këtu, pasqyrojnë një numër të drejtave themelore të qytetarëve: të drejtën për t'u informuar, të drejtën për t'u dëgjuar, dhe të drejtën për të ndikuar në ato aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me kushtet jetësore të qytetarëve. Këto të drejta mund të ekzekutohen përmes p.sh., pjesëmarrjes në ngjarje/aktivitete konsultative urbane, debate publike, anketime, takime, grupe punuese dhe komisione si dhe në organe tjera. Por një

Udhëzues për pjesëmarrjen publike në planifikimin hapësinor

nga çështjet kyçe është të sigurohet që qytetarët të informohen në mënyrë të duhur rreth iniciativave lokale dhe qendrore si dhe krijimit të kushteve nga ana e autoriteteve për angazhimin e tyre në këto iniciativa.

Figura 2. Vazhdimësia e pjesëmarrjes-Llojet e pjesëmarrjes



Burimi: MuSPP UN-Habitat

Të gjitha këto nivele krijojnë një kontinuitet, i cili praktikisht sjell një zhvillim gradual të pjesëmarrjes nga faza më e ulët deri në fazat me intensitet më të lartë. Edhe pse lloje të ndryshme të projekteve dhe aktiviteteve mund të kërkojnë vetëm disa prej këtyre formave të pjesëmarrjes, është e rëndësishme të merret parasysh se niveli i lartë i pjesëmarrjes nuk ka gjasa të arrihet pa përfshirjen e qytetarëve që në fazat më të hershme të saj.

Prezantimi tabelar i të gjitha niveleve të radhitura më poshtë, mund të gjendet në Shtojcën 1: Nivelet e pjesëmarrjes së publikut.

## 2.4.1 INFORMIMI

Foto 5. Prezantimi publik i vizionimit të Malishevës



Izvor: UN-Habitat Kosovo

Informimi mbështet nivelet e ndryshme të pjesëmarrjes, dhe mund të aplikohet edhe si një nivel i vetëm i pjesëmarrjes në rrethana të caktuara.

### Koncepti

- Qytetarët janë të informuar për të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre
- Komunikimi njëanshëm, edhe në qoftë se informacioni është dhënë në bazë të kërkesës së akterëve/palëve të interesit
- Nuk ofron mundësi për të dhënë komente ose për të hyrë në negociata
- Informacioni përcillet nëpërmjet kanaleve që janë të arritshme për të gjithë anëtarët e komunitetit

### Aplikimi në procesin e planifikimit hapësinor

- Informacioni rreth planifikimit hapësinor shkëmbehet me akterët kyç të identifikuar
- Fushata kryesore informuese mbahet para ngjarjeve/aktiviteteve të konsultimit, debateve publike dhe shqyrtimit publik
- Autoriteti raporton për rrjedhën e veprimit për të cilin është vendosur, dhe që nuk ndikon në të tjerët, p.sh. informacioni në lidhje me tenderët, raportet vjetore të monitorimit të zbatimit të planeve, raportet e shqyrtimit publik (po ashtu i paraparë edhe me Udhëzimin Administrativ Nr.05/2014);

### Metodat

Metodat vijuese mund të merren parasysh për informimin:

- Njoftimet përmes shtypit, radios dhe TV-së,
- Tabelat informative nëpër institucione dhe qytet
- Posterat
- Fletushkat dhe buletinët
- Publikimet në ueb-faqe
- Ditët e hapura në komuna dhe ministri

Udhëzues për pjesëmarrjen publike në planifikimin hapësinor

## 2.4.2 KONSULTIMI

Foto 6. Diskutime në prezantimin publik të vizionimit të Malishevës



Burimi: UN-Habitat MuSPP

Konsultimi është adekuat kur individëve iu ofrohen/jipen vendime mbi atë që do të ndodhë - por ende nuk iu jipet mundësia që mendimet ose pjesëmarrja e tyre të mund të ndikojnë në realizimin konkret të planeve.

### Koncepti

- Komunikim i dyanshëm, ku aktorët kanë mundësi të shprehin sugjerimet dhe shqetësimet
- Nuk garanton se idetë dhe opinionet e aktorëve do të përdoren/mirren parasysh apo ashtu siç kanë synuar ata
- Zakonisht realizohet nëpërmjet takimeve të kryesura nga një person që përfaqëson nivele të ndryshme të qeverisjes apo organeve të tyre, dëgjimeve publike (debateve) dhe anketimeve.

### Aplikimi në procesin e planifikimit hapësinor

- Konsultimet janë element kyç në procesin e hartimit të planeve. Konsultimi fokusohet në zhvillimin e vizionit, misionit, qëllimeve dhe objektivave të përbashkëta përmes diskutimeve plenare, grupeve punuese, dhe takimeve tematike
- Gjatë kalimit nga një fazë në tjetrën të procesit të hartimit të planeve (Udhëzimi Administrativ 05/2014 parasheh të paktën një takim konsultativ/diskutim publik në çdo fazë të procesit të planifikimit);
- Ju dhe/ose iniciatori i propozimeve mund t'i marrë komentet dhe t'i përdor ato për të zgjedhur një nga opsionet ose t'i modifikojë ato
- Para finalizimit të planeve (gjatë shqyrtimit publik, siç parashihet me Udhëzimin Administrativ Nr.05 / 2014).

### Metodat

Metodat vijuese mund të merren parasysh për konsultimin:

- Anketimet, pyetësorët, sondazhet
- Mbledhjet e kuvendit komunal
- Debatet publike dhe shqyrtimet publike
- Takimet konsultative/diskutimet publike
- Simulimet ku mundësitë dhe kufizimet janë të qarta

Udhëzues për pjesëmarrjen publike në planifikimin hapësinor

- Sigurimi i një qasjeje publike të drejtpërdrejtë për të parë dhe komentuar të dhënat, hartat, grafikonët dhe të gjitha planet për palët e interesit.

### 2.4.3 MARRJA E VENDIMEVE SË BASHKU

Foto 7. Punëtorja e dizajnit për rregullimin e parkut të Moronicës, PIK në Junik



Burimi: UN-Habitat MuSPP

Marrja e vendimeve së bashku është një nivel më i lartë i pjesëmarrjes, për shkak se një nivel i tillë iu mundëson individëve për të arritur të zgjidhjet e caktuara dhe për t'i realizuar ato.

#### Koncepti

- Bashkëveprimi i akterëve/palëve të interesit në mënyrë që të kuptojnë njëri-tjetrin dhe të arrijnë në qëndrime të negociuara që janë të pranueshme për tërë grupin
- Sidoqoftë, individët dhe grupet e cenushme/të marginalizuara shpesh synojnë të heshtin apo të pajtohen në mënyrë pasive me zgjidhjen e negociuar
- Zbatimi i strategjive që sigurojnë se opinionet e burrave dhe grave konsiderohen në mënyrë të barabartë, sidomos në këtë fazë
- Shprehja e fuqisë dhe e përgjegjësisë për rezultatet që mund të pasojnë. Negociatat në këtë fazë reflektojnë shkallë të ndryshme të angazhimit të ushtruar nga individët dhe grupet

#### Aplikimi në procesin e planifikimit hapësinor

- Përfshirja në konsultime për planifikimin hapësinor, në grupe pjesëmarrëse, iu mundëson akterëve/palëve të interesit që të marrin pjesë në vendimmarrje për të ardhmen e qytetit dhe shfrytëzimin e burimeve njerëzore, natyrore dhe financiare drejt zbatimit/realizimit të vizionit të qytetit
- Atëherë kur paraqitet nevoja për të përcaktuar vizionin, qëllimet dhe objektivat, prioritetet strategjike dhe elementet tjera substanciale të planeve përkatëse (siç parashihet me Udhëzimin Administrativ nr. 05/2014)
- Ka kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur

#### Metodat

Metodat vijuese mund të merren parasysh për ndërtimin e konsensusit/marrjen e vendimeve së bashku:

- Metodat e informimit për të filluar procesin;

Udhëzues për pjesëmarrjen publike në planifikimin hapësinor

- Sondazhet/anketimet online, p.sh. votimi për përcaktimin e prioriteteve strategjike;
- Debatet e hapura, punëtoritë, takimet ballë për ballë;
- Analiza SWOT për të kuptuar se ku qëndroni;
- Shkëmbimi i ideve, sondazhet/anketimet për të zhvilluar disa opsione;
- Punëtoritë e vizionimit - Metodatat për të vendosur së bashku për krijimin e një vizioni të përbashkët<sup>1</sup>.
- Punëtoritë për planifikimin e veprimeve.

---

<sup>1</sup>Shih: "Vizionimi si mjet i planifikimit pjesëmarrës. Të mësuarit nga praktika e Kosovës"

## 2.4.4 TË VEPRUARIT SË BASHKU

Foto 8. Grupet e ndryshme etnike duke planifikuar së bashku mjedisin e jashtëm të shkollës e Radevës / Komuna e Graçanicës



Burimi: UN-Habitat MuSPP

Të vepruarit së bashku mund të përfshijë përpjekje të vogla të koordinuara apo edhe formësimin e vazhdueshëm të organizatave me interesa të ndryshme.

### Koncepti

- Veprimet kolektive të cilat rezultojnë me një kombinim të pasojave përfituese, të dëmshme dhe neutrale të cilat ndahen në mënyrë të barabartë nga të gjithë partnerët/palët e interesit;
- Llogaridhënia është themelore në këtë fazë;
- Shkëmbimi në mes të akterëve/palëve të interesit me status të ngjashëm, të barabartë dhe drejt një qëllimi të përbashkët

### Aplikimi në procesin e planifikimit hapësinor

- Planifikimi hapësinor rezulton në një shkallë të ndarjes së përfitimeve dhe rreziqeve të mundshme në mes të akterëve/palëve të interesit, por përpiqet të zbusë rrezikun nëpërmjet ndërtimit të konsensusit dhe analizës së projekteve zhvillimore në aspektin e ndikimit të tyre financiar, socio-ekonomik dhe ekologjik;
- Vendosja e partneriteteve publiko-private për ofrimin e shërbimeve, mirëmbajtjen e ndërtesave të banimit, etj, është një nga mënyrat për të rritur efikasitetin dhe/apo kosto-efektivitetin e qeverisjes lokale;
- Qytetarët dhe akterët tjerë angazhohen në zbatimin e planeve përmes p.sh. pjesëmarrjes në planifikimin apo dizajnimin e mjedisit të tyre.

### Metodat

Metodat vijuese mund të merren parasysh për të vepruarit së bashku:

- Metodat e informimit për të filluar procesin;
- Ushtrimet për ndërtimin e ekipit;

Udhëzues për pjesëmarrjen publike në planifikimin hapësinor



- Ushtrimet e dizajnit;
- Strukturat e përkohshme si palët punuese dhe grupet drejtuese si fokus për vendimmarrje dhe llogaridhënie.

#### 2.4.5 MBËSHTETJA E INICIATIVAVE LOKALE

Mbështetja e aktiviteteve të komunitetit të veçantë të pavarur do të thotë të ndihmohet të tjerët për të krijuar dhe realizuar planet e tyre. Bartësit e mjeteve që çojnë përpara këtë nivel të mbështetjes, natyrisht, mund të kufizojnë atë që ata duan të mbështesin.

##### Koncepti

- Niveli më i lartë i përpjekjeve të pjesëmarrjes
- Akterët/palët e interesit e marrin përgjegjësinë e plotë për projektet që kanë ndikim tek ata drejtpërsëdrejti dhe janë të gatshëm për të mësuar se si të realizojnë procesin nga fillimi deri në fund.

##### Aplikimi në procesin e planifikimit hapësinor

- Formë e pjesëmarrjes që mund të aplikohet në zbatimin e planit të veprimit, sidomos për projektet të lagjeve ose të atyre të nivelit tëkomunitetit;

Kjo nuk është domosdoshmërisht e përshtatshme kur aktivitetet e komunitetit shihen si "një gjë e mirë" në teori dhe shtyhen nga individët duke filluar nga lartë, ose kur nuk ka përkushtim për të ndihmuar përgatitjen dhe mbështetjen, as mjetet për të vazhduar aktivitetet në një afat më të gjatë.

- Në rastet kur koha është e shkurtër.

##### Metodat

Metodat vijuese mund të merren parasysh për mbështetjen e iniciativave lokale:

- Punëtoritë për të ndihmuar grupet e komunitetit në krijimin e një vizioni të përbashkët dhe planifikimin e veprimeve të tyre;
- Ushtrimet për ndërtimin e ekipit;
- Planifikimi i angazhimit;
- Punëtoritë për projektim, ngritje të fondeve dhe publicitet;
- Vizitat në projekte të ngjashme;
- Strukturat e përkohshme si palët punues edhe grupet drejtuese si një fokus për vendimmarrje dhe llogaridhënie.
- Strukturat afatgjata, kur interesat e komunitetit janë të përfaqësuara denjësisht

### III. HAPAT E PËRGJITHSHËM PËR Pjesëmarrjen Publike

Pjesëmarrja është një proces në të cilin qytetarët, që janë përgjegjës për ta realizuar atë, duhet të mendojnë për atë që ata e dëshirojnë, të konsiderojnë disa opsione, dhe të punojnë rreth asaj që duhet të kryhet. Ashtu si çdo proces tjetër, hartimi i planit për pjesëmarrjen publike duhet të mendohet në kuptim të fazave:

#### Inicimi

Faza në të cilën diçka e paraqet nevojën për të përfshirë qytetarët, dhe ekipi përgjegjës për procesin fillon të mendoj se çfarë të bëjë në aspektin e burimeve njerëzore dhe financiare. Kjo fazë përfshin hapin 1-rë të listuar më poshtë.

#### Përgatitja

Periodha kur personi ose ekipi përgjegjës për pjesëmarrjen e publikut mendon për tërë procesin, analizon akterët/palët e interesit, pajtohet rreth qasjes dhe harton një plan të detajuar të veprimit. Kjo fazë përfshin hapat 2, 3 dhe 4 të listuar më poshtë.

#### Zbatimi

Faza në të cilën metodat e pjesëmarrjes përdoren/aplikohen për t'i sjellur akterët kyç në komunitet. Kjo fazë përfshin hapin e 5-të të listuar më poshtë.

#### Vazhdimi

Çfarë ndodh në këtë fazë do të varet shumë nga niveli i pjesëmarrjes - kjo mund të përfshijë raportimin lidhur me konsultimet e mbajtura si dhe poashtu monitorimin dhe vlerësimin. Kjo fazë përfshin hapat 6-të dhe 7-të të listuar më poshtë.

#### 3.1 HAPI 1: INICIMI DHE MENAXHIMI

Procesi i pjesëmarrjes dhe konsultimit konsiderohet i mirë, kur ai planifikohet me kujdes në detaje dhe përmban qëllime të qarta.

Plani i pjesëmarrjes publike duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër, qëllimin, fazat e projektit, duke përfshirë format e pjesëmarrjes të cilat do të përdoren gjatë gjithë procesit të planifikimit. Autoriteti i planifikimit hapësinor duhet të identifikojë një anëtar të personelit për të përgatitur dhe menaxhuar planin e pjesëmarrjes. Pas emërimit të anëtarit të personelit si përgjegjës për planin e përgjithshëm të pjesëmarrjes publike, anëtarë të tjerë të personelit duhet të caktohen për t'u marrë me aktivitete specifike të pjesëmarrjes. Format standarde të komunikimit duhet të përcaktohen në mes të Autoritetit të Planifikimit Hapësinor dhe akterëve të tjerë të përfshirë në këtë proces. Është e rëndësishme që të diskutohet buxheti për zbatimin e planit të pjesëmarrjes si dhe mjetet financiare për organizimin e aktiviteteve për pjesëmarrjen e publikut. Për ilustrim, shih Shtojcën 2 - Korniza kohore e konsultimeve për planin hapësinor.

*Autoriteti i Planifikimit Hapësinor siguron dhe inkurajon pjesëmarrjen publike transparente në procesin e planifikimit dhe të vendimmarrjes, duke ofruar qasje publike në të dhëna, harta, grafikone dhe në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor për palët e interesuara.*

*(Siç është paraparë me Udhëzimin Administrativ nr. 05/2014)*

## 3.2 HAPI2: PËRCAKTIMI I AKTERËVE/PALËVE TË INTERESIT TË CILËT DUHET TË PËRFSHIHEN NË PROCESIN E PJESËMARRJES PUBLIKE

### 3.2.1 IDENTIFIKONI AKTERËT DHE ROLET E TYRE

Me qëllim të përcaktimit të nivelit të pjesëmarrjes për secilin aktivitet, duhet të bëhet një analizë e akterëve. Lista e akterëve duhet të përfshijë të gjithë individët apo subjektet që:

- Ndikohen nga çështja ose veprimet e të cilëve ndikojnë fuqishëm në çështjen përkatëse;
- Mund të kontribuojnë me burime njerëzore, financiare, teknike dhe burime të tjera në formulimin dhe zbatimin e Dokumentit të Planifikimit Hapësinor;
- Kontrollon ose ndikojnë në zbatimin e Dokumentit të Planifikimit Hapësinor.

Matrica e paraqitur në figurën 1 më poshtë sqaron procesin e përcaktimit të akterëve, duke krijuar të paktën katër grupe të tyre, varësisht nga interesi dhe ndikimi që kanë.

Figura 3. Matrica e interesit-ndikimit

	Ndikim të ulët	Ndikim të lartë
Interes i vogël	Akterë me potencial të kufizuar të përfshirjes	Akterë me fuqi vendimmarrëse
Interes i madh	Akterë i rëndësishëm që mund të ketë nevojë për inkurajim dhe mbështetje	Akterë me ndikim maksimal në zgjidhjen e çështjes

Burimi: UN-Habitat MuSPP

Gjatë analizës së akterëve duhet të ndiqen parimet e mëposhtme:

- Përfshirja,
- Relevanca/Rëndësia, dhe
- Ndjeshmëria gjinore

Rregullat në bazë të cilave shoqëria civile do të angazhohet në procesin e planifikimit duhet të përcaktohen qartë. Rolet e zyrtarëve komunalë, politikanëve, zyrtarëve të zgjedhur, shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit duhet të kuptohen qartë.

### 3.2.2 IDENTIFIKONI METODAT E DUHURA PËR TË INFORMUAR AKTERËT RRETH PROCESIT(VE) TË PJESËMARRJES PUBLIKE

- Cilat metoda (takime informative, komunikata për shtyp) do të jenë më efektive në informimin e akterëve për procesin(et) e pjesëmarrjes publike?

Disa persona do të dëshirojnë - ose kërkojnë - përfshirje më të madhe se të tjerët. Të tjerët do të dëshirojnë që të mos jenë të përfshirë. Identifikimi i këtyre interesave të ndryshme të akterëve dhe negociimi i nivelit të pjesëmarrjes që është i përshtatshëm dhe i pranueshëm për ta, është një tjetër aspekt i kornizës së pjesëmarrjes.

Udhëzues për pjesëmarrjen publike në planifikimin hapësinor

Strategjitë për mobilizimin e akterëve mund të marrin formën e:

- Takimeve në hapësirat e objektit komunal për të krijuar një "ndjenjë" tek akterët rreth një çështjeje specifike urbane;
- Takimeve në hapësirën ku mbahet Asambleja Komunale për t'i dhënë qytetarëve mundësinë për t'u takuar me anëtarët/këshilltarët e Asamblesë Komunale dhe për të shqyrtuar progresin e premtimeve të tyre elektorale; ose
- Takimeve të vogla të lagjes për të shkëmbyer informacione, identifikuar problemet dhe propozuar zgjidhje.

Përdorimi i "kampionëve lokal", ku procesi i pjesëmarrjes udhëhiqet nga dikush tjetër dhe jo nga autoriteti i planifikimit si një mënyrë për të larguar fokusin nga një person.

*Autoritetet e Planifikimit Hapësinor informojnë palët e interesit në lidhje me aktivitetet e pjesëmarrjes publike përmes ueb-faqeve të tyre përkatëse të internetit, mediave shtetërore apo lokale, fjesave, letrave njoftuese publike dhe formave tjera të komunikimit.*

*Autoriteti i Planifikimit Hapësinor ndërmerr një fushatë informimi për të inkurajuar pjesëmarrjen e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor.*

*(siç parashihet me Udhëzimin Administrativ nr. 05/2014)*

*Siç parashihet me Udhëzimin Administrativ nr. 05/2014, MMPH-ja dhe komunat duhet të marrin parasysh nevojat e të rinjve, të moshuarve, grupeve minoritare, personave me nevoja të veçanta, sektorit publik dhe privat, OJQ-ve, ekspertëve si dhe çështjet gjinore.*

*"Akte të përfshirë në pjesëmarrjen publike ndihmojnë autoritetin e planifikimit hapësinor në zgjedhjen e metodës/qasjes më të përshtatshme për të siguruar ndikim maksimal - p.sh. në përzgjedhjen e gjubës që duhet të përdoret dhe nivelin e informacionit që duhet të sigurohet për akterët rreth çështjes në diskutim. Një analizë adekuate e akterëve e bën më të lehtë ndarjen e tyre në grupe për të siguruar diskutime më të fokusuara ku akterët e pranishëm rreth një çështjeje të veçantë janë në të njëjtin nivel në kuptim të historikut dhe të kuptuarit të çështjes. Sigurimi paraprak i tërë informacionit të duhur do të mundësojë që akterët të mund të marrin pjesë në mënyrë kuptimplotë dhe të përgatitur në seancë"* (Template for Developing Guidelines on Public Participation, Public Service Commission of South Africa, 2010)

*"Pjesëmarrja duhet të bazohet në një kontratë " ku sqarohen objektivat e procesit, statuti i pjesëmarrësve, metodat dhe rregullat e zgjedhura". E gjithë përvoja e "rrjetit" konfirmon këtë orientim, duke sugjeruar se për të pasur një proces të "strukturuar" shpesh është e mjaftueshme që në mënyrë të qartë dhe të saktë të përcaktohet koha, hapësirat, rregullat dhe rolet që iu garantojnë të gjithëve të drejta të barabarta të pjesëmarrjes, të shprehurit dhe për të qenë i dëgjuar. (European Handbook for Participation, The Urbact Partecipando Network)*

*Instituti Evropian për Pjesëmarrjen Publike argumenton se një komponent thelbësor i pjesëmarrjes së vërtetë është mundësia që akterët/palët e interesit të përfshirë, të ndryshojnë mendjen e tyre, e cila mundëson që ata të arrijnë në të kuptuarit e përbashkët të çështjeve dhe zgjidhjeve, në vend se vetëm të shkëmbimit të pikëpamjeve në mes tyre. (Public Participation in the Development Porcess, European Urban Knowledge Network, 2013).*

### 3.3 HAPI 3: IDENTIFIKIMI I LLOJEVE TË PJESËMARRJES

#### 3.3.1 IDENTIFIKONI LLOJIN (-ET) MË TË PËRSHTATSHËM TË PJESËMARRJES PUBLIKE QË DUHET TË PËRDORET/APLIKOHET

- Çfarë lloje të pjesëmarrjes publike do të jenë më të përshtatshme sipas rrethanave të veçanta?
- Cilat janë përparësitë dhe dobësitë e llojeve përkatëse?

Udhëzues për pjesëmarrjen publike në planifikimin hapësinor

- Në çka bazohet zgjedhja e një lloji? (kosto efektive, arritja, pritjet e akterëve)

### 3.4 HAPI 4: HARTIMI I PLANIT TË DETAJUAR TË VEPRIMIT

#### 3.4.1 IDENTIFIKONI KAPACITETET E KËRKUARA PËR LEHTËSIMIN E PJESËMARRJES PUBLIKE

- Cilat janë kapacitetet e nevojshme të autoriteteve të planifikimit hapësinor për të lehtësuar pjesëmarrjen e publikut? (nevojat sa i përket por pa u kufizuar në, siç janë aftësitë e lehtësimit/fasilitimit të procesit, aftësitë hulumtuese/kërkimore, aftësitë për ndërmjetësim dhe aftësitë intervistuese)
- Cilat janë kapacitetet e nevojshme të akterëve që të marrin pjesë në pjesëmarrjen publike?

#### 3.4.2 IDENTIFIKONI AKTIVITETET DHE BURIMET E KËRKUARA PËR PJESËMARRJEN PUBLIKE

- Cilat aktivitete do të duhet të lehtësojnë pjesëmarrjen efektive të publikut? (Shih Shtojcat 3 dhe 4 mbi Matricën e strukturës së ndarjes së punës dhe aktivitetit/përgjegjësi)
- Cilat burime (në aspektin e burimeve njerëzore, kostos, kohës dhe logjistikës) do të jenë të nevojshme për secilin prej aktiviteteve në planin e detajuar?

- Cilat burime janë në dispozicion për zbatimin e planit të veprimit?
- Cilat janë zbrazëtirat ndërmjet burimeve në dispozicion dhe atyre të nevojshme?
- Çfarë burimesh mund të hulumtohen për t'i adresuar zbrazëtirat?
- A është hartuar një plan i detajuar i veprimit, me afate kohore, rezultate të pritura dhe përgjegjësitë?
  - Zgjidhni vendin e duhur për ngjarjet (merrni në konsideratë kohën/vendet të përshtatshme për të gjitha gjinitë për aktivitetet e pjesëmarrjes së publikut)
  - Agjenda duhet të hartohet dhe shpërndahet në kohë në të gjitha gjuhët e kërkuara
  - Kontrolloni pajisjet – sistemin e zërimit, laptopin, projektorin, nevojën për përkthim etj.
  - Përgatitni dhe kontrolloni të gjitha materialet e kërkuara, të tilla si: hartat, tabelat, broshurat, CD-të, etj.
  - A ka qasje për personat me nevoja të veçanta?
  - Organizoni hapësirën e dhomës ku do të mbahet aktiviteti (p.sh. një hapësirë në formën U mund të jetë e dobishme për një aktivitet me më shumë pjesëmarrje, ku synoni të merrni komente (reagime) nga audienca juaj).
  - Merrni në konsideratë krijimin e një ambienti të rehatshëm në dhomën e takimeve, përfshirë aspektet e tilla si: pijet freskuese, ngrohjen, ftohjen, etj.

*Siç është paraparë me Udhëzimin Administrativ nr. 05/2014, njoftimi publik duhet të bëhet së paku 8 ditë para diskutimit publik (përmes ftesave, letrave njoftuese publike, mediave shtetërore apo lokale, etj)*

### 3.5 HAPI 5: ZBATIMI I PROCESIT TË PJESËMARRJES PUBLIKE

Me qëllim që pjesëmarrja publike të jetë e suksesshme, duhet të merren në konsideratë të gjitha detajet-përfshirë logjistikën. Varësisht nga niveli i pjesëmarrjes, si dhe mjetet dhe teknikat që do të përdoren, Autoriteti i Planifikimit Hapësinor duhet të kujdeset për këto çështje:

#### 3.5.1 TË SIGUROJË ARANZHIME TË DUHURA LOGJISTIKE, TË TILLA SI:

- Kush do të kontaktoj/angazhohet me publikun?
- Kush do t'i regjistroj komentet dhe rekomandimet e publikut?
- Si do të menaxhohen rreziqet, përfshirë
  - \* Fuqizimi/dominimi i akterëve ndaj të tjerëve
  - \* Mos ndjekja e agjendës dhe çështjeve që duhet të diskutohen
  - \* Sjellja penguese/ jo e duhur e akterëve

### 3.6 HAPI 6: KTHIMI I PËRGJIGJEVE/SQARIMEVE PËR KOMENTET DHE REKOMANDIMET E AKTERËVE/PALËVE TË INTERESIT

#### 3.6.1 INFORMONI TË GJITHË AKTERËT LIDHUR ME REZULTATIN E PROCESIT TË PJESËMARRJES PUBLIKE SI DHE PO ASHTU KTHENI PËRGJIGJE PËR PËRFSHIRJEN, APO JO, TË KOMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE TË TYRE NË DOKUMENTIN E PLANIFIKIMIT

- A janë informuar akterët se si kontributet e tyre kanë ndikuar në vendime?
- A është identifikuar forma dhe gjuha e duhur në bazë të cilave duhet të kthehen përgjigjet/sqarimet?
- Komunikatat për media ku duhet të arrihet një numër shumë i madh i publikut, për shembull, për njoftimin e një politike specifike
- Raportet e publikuara të shpërndara tek akterët apo të postuara në ueb-faqe
- A janë lejuar akterët të ofrojnë komente/reagime lidhur me:
- Se a janë të kënaqur me procesin e pjesëmarrjes së publikut?
- Sfidat të cilat i kanë identifikuar në proces?

*Qytetarët ofrojnë propozime dhe vërejtje në këtë mënyrë:*

*-kanë qasje direkte në projekt dokumentin e planifikimit hapësinor;*

*-shkruajnë propozime dhe vërejtje në librin e vërejtjeve; dhe*

*-japin sugjerime verbale, komente dhe propozime dhe bëjnë pyetje gjatë*

*prezantimeve publike për çështje të caktuara. (Siç është paraparë me*

*Udhëzimin Administrativ nr. 05/2014)*

*Të gjitha propozimet dhe vërejtjet e paraqitura nga publiku gjatë shqyrtimit publik (30 ditë për projekt-dokumentine planifikimit hapësinor dhe 15 deri në 30 ditë për ndryshime në projekt-dokumentine planifikimit hapësinor) janë të përfshira në raportin e shqyrtimit publik.*

*Raporti duhet të përmbajë arsyetimin për miratimin ose refuzimin e propozimeve dhe kundërshtimeve, duke përjashtuar propozimet dhe vërejtjet e dhëna pas afatit. Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të MMPH-së dhe/ose Komunës.*

*(Siç është paraparë në Udhëzimin Administrativ nr.05/2014)*

## **3.7 HAPI 7: VLERËSIMI DHE MONITORIMI**

### **3.7.1 SHQYRTONI PROCESET DHE INICIATIVAT E PJESËMARRJES PUBLIKE**

- A ka përdorur autoriteti i planifikimit hapësinor instrumente efektive (p.sh. sondazhe/anketime, shqyrtime) dhe tregues/indikator për të vlerësuar nëse procesi dhe/ose iniciativat e pjesëmarrjes publike kanë arritur objektivat e tyre?
- A janë identifikuar kufizimet dhe sfidat në procesin e pjesëmarrjes publike?
- A ka gjetur autoriteti i planifikimit hapësinor mënyra për të përmirësuar pjesëmarrjen publike?
- A janë përdorur mësimet nga procesi për planifikimin e iniciativave të ardhshme të pjesëmarrjes publike?

Rekomandohet të përcaktohen/zhvillohen indikatorët për të monitoruar zbatimin e planit të pjesëmarrjes, deri në çfarë mase janë arritur qëllimet dhe objektivat e planit të pjesëmarrjes së publikut, si dhe për të vlerësuar procesin e përgjithshëm të pjesëmarrjes.

Mbledhja e të dhënave mund të bëhet duke aplikuar pyetësorët tek komuniteti ose zhvillimin e fokus grupeve me njerëz të cilët kanë marrë pjesë në këtë proces. (Shih Shtojcën 5, Shembull i pyetësorit të vlerësimit)

Autoriteti i planifikimit hapësinor duhet të informohet në lidhje me nivelin e kënaqshmërisë së komunitetit për procesin e pjesëmarrjes. Në fund, të dhënat e marra nga procesi i monitorimit do t'i shërbejnë autoritetit të planifikimit hapësinor në shqyrtimin e planit të tij të pjesëmarrjes në të ardhmen.

## IV. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

*"Proceset efektive të pjesëmarrjes publike jo vetëm që përmirësojnë kualitetin e projekteve apo vendimeve, por gjithashtu ndërtojnë marrëdhënie për punën e ardhshme. Shumë procese të pjesëmarrjes publike dështojnë në arritjen e secilit prej këtyre rezultateve për shkak të një tendence për të lëvizur shumë shpejt në zbatimin e aktiviteteve "të vjetra dhe të njohura", pa identifikuar në mënyrë të qartë objektivat dhe shtrirjen e programit, dhelose nivelin e preferuar të pjesëmarrjes së publikut." (Burimi: Park Management Plan Review Public Participation Program - Framework Paper, May, 2007 by Parks Canada).*

Duke iu referuar angazhimit të akterëve/palëve të interesit, nuk është e mjaftueshme të deklarohet se të gjithë akterët duhet të kenë rol në përcaktimin e të ardhmes së vendbanimeve të tyre dhe në qasjen e shërbimeve dhe mundësive. Është e rëndësishme të sigurohet pjesëmarrje e barabartë e burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, në këto procese. Qasja gjinore në planifikimin dhe menaxhimin urban nënkupton se nevojat dhe prioritetet specifike të burrave dhe grave janë të përfshira në vlerësimin dhe priorizimin e gjendjes dhe se ndikimi i planifikimit tek burrat dhe gratë është shqyrtuar me kujdes para marrjes së çfarëdo vendimi. Në mënyrë që të sigurohet një përfaqësim i plotë i komunitetit në procesin e vendimmarrjes urbane, është thelbësore të sigurohet pjesëmarrje e konsiderueshme e të gjitha grupeve etnike, si dhe të atyre grupeve që janë shpesh të marginalizuara, p.sh. me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta, të moshuarit ose personat e varfër.

Është gjithashtu e rëndësishme të sigurohet se ndarja e duhur e buxhetit është bërë në kohë dhe se proceset janë llogaridhënëse ndaj të gjithë atyre që janë përfshirë. Duhet t'i jepet kujdes i veçantë caktimit të kohës dhe lokacionit.

### 4.1 ÇKA E KARAKTERIZON NJË PJESËMARRJE TË MIRË?

Bën ndryshime: Qëllimi i pjesëmarrjes është arritja e ndryshimeve në lidhje me qëllimin e identifikuar; gjithashtu mund të bëjë ndryshime tek të gjithë ata që janë përfshirë në aspektin e të mësuarit, besimit dhe ndjenjës së qytetarisë aktive. Kjo kërkon angazhim aktiv nga të gjitha palët për të ndryshuar.

Vullnetare: Njerëzit mund të inkurajohen për përfshirje, por pjesëmarrja efektive kërkon që ata të zgjedhin që të jenë të përfshirë. Pjesëmarrja nuk mund të jetë e detyrueshme.

Transparenca, sinqeriteti dhe qartësia: Në lidhje me qëllimin, kufijtë e asaj se çka mund dhe nuk mund të ndryshohet, kush mund të përfshihet dhe si, dhe çfarë ndodh si rezultat i kësaj.

Ndërveprueshmëria: Procesi i angazhimit apo përfshirjes nuk është vetëm prezantimi i të dhënave dhe informacionit, ai gjithashtu ka të bëjë edhe me marrjen e informacionit nga pjesëmarrësit. Ndërveprueshmëria është një formë më interaktive e angazhimit publik, se sa thjesht vetëm informimi i publikut në lidhje me atë që ju jeni duke e bërë.

Pronësia: Kontrolli i procesit do t'i mbetet Autoritetit të Planifikimit Hapësinor. Procesi gjithmonë mund të negociohet dhe diskutohet me pjesëmarrësit; megjithatë vendimi përfundimtar i mbetet autoriteteve përkatëse. Pjesëmarrja efektive nënkupton sigurimin e "pronësisë" sa më të gjerë të mundshme të një iniciative, duke ndarë përgjegjësinë dhe kompetencën e vendimmarrjes. Si e tillë, është shumë i rëndësishëm planifikimi në atë mënyrë që të njihen nevojat unike dhe aftësitë e të gjitha grupeve të akterëve, veçanërisht ato të grave, si dhe të burrave.

Burimet e duhura: për menaxhimin e duhur të procesit dhe dhënien e rezultateve.



Pjesëmarrësit e duhur: Përfaqësues dhe/ose gjithëpërfshirës, varësisht nga qëllimi i fazës së procesit, duke iu dhënë mbështetje të veçantë dhe inkurajim grupeve të përjashtuara tradicionalisht, atëherë kur përfshirja e tyre është e përshtatshme.

Qasshmëria: Nuk duhet të përjashtohet asnjë pjesëmarrës për shkak të mungesës së qasjes fizike në vendtakime, apo mbështetjes së duhur, orarit, etj.

Llogaridhënia: Proceset pjesëmarrëse duhet të jenë llogaridhënëse për të gjithë ata që janë të përfshirë (përfshirë organizatën që mund të jetë duke e drejtuar/organizuar aktivitetin e caktuar, dhe për komunitetin më të gjerë). Kjo kërkon mbajtjen e duhur të shënimeve dhe raportimit, si të proceseve ashtu dhe të rezultateve.

Kompetenca/Fuqia: Proceset pjesëmarrëse duhet të kenë kompetenca të mjaftueshme për të arritur objektivat e dakorduara. Kjo mund të kërkojë një ndryshim në marrëveshjet ekzistuese të ndarjes së kompetencave.

Mësimi dhe zhvillimi: Proceset pjesëmarrëse duhet të synojnë mbështetjen e një klime të të mësuarit dhe zhvillimit të ndërsjellë tek të gjithë ata që janë të përfshirë.

## 4.2 NATYRA E PJESËMARRJES EFEKTIVE

Pjesëmarrja funksionon më së miri tek të gjithë të të interesuarit, atëherë kur secili prej akterëve kyç është i kënaqur me nivelin e pjesëmarrjes në të cilin ata janë të përfshirë. Detyrë e vështirë për menaxherin e procesit është identifikimi i akterëve dhe interesave të tyre, t'u ndihmojë atyre të definojnë se çfarë duan nga procesi dhe të negociojë rrugën me ta për të arritur.

Fuqia e menaxherit të procesit pjesëmarrës shtrihet në të ndikuarit se kush do të përfitojë. Pjesëmarrja nuk është një proces neutral. Prandaj, personi udhëheqës i procesit pjesëmarrës duhet të pyes veten:

- Cili është qëllimi i procesit?
- Kush përfiton? Kush paguan? Kush kontrollon?

Zhvillimi i procesit të pjesëmarrjes efektive mund të jetë një sfidë e madhe, me akterë të ndryshëm që kërkojnë nivele të ndryshme të pjesëmarrjes, dhe duke qenë në faza të ndryshme.

## 4.3 RREZIQET E MUNDSHME

Njerëzit në përgjithësi shfaqin më shumë pakënaqësinë e tyre ndaj autoriteteve, se sa që bashkëpunojnë me ta. Kjo ndryshon kur njerëzit kanë një interes të madh personal apo interes të komunitetit në veprimet e autoriteteve dhe mund t'i shohin ata si një mundësi, një përfitim ose si një kërcënim për interesat e tyre.

Rreziqet ndaj procesit përfshijnë:

- Krijimin e proceseve pjesëmarrëse paralele që nuk janë të integruara me strukturat ekzistuese sociale dhe politike
- Besimin e kufizuar, konfliktin e interesave dhe kompetencave të ndryshme ndërmjet grupeve të interesit që rezultojnë në çrregullim të procesit dhe keqpërdorim të besimit
- Perceptime të ndryshme nga akterë të ndryshëm në lidhje me procesin e pjesëmarrjes
- Pritjet e tepruara nga disa akterë për rezultatet e procesit të pjesëmarrjes
- Ndarjet e pamjaftueshme të informacioneve ndërmjet pjesëmarrësve në proces
- Proceset e pjesëmarrjes të planifikuara dobët që nuk janë të kufizuara dhe të buxhetuara realisht, apo që janë vetëm një përpjekje simbolike nga ana e organizatorëve

Udhëzues për pjesëmarrjen publike në planifikimin hapësinor

- Mungesën e vullnetit politik tek zyrtarët e qeverisë për të lejuar pjesëmarrjen e gjerë, sepse kanë frikë nga humbja e fuqisë dhe e ndikimit
- Kohën, kapacitetet dhe financat e kufizuara

#### 4.4 SHEMBUJ TË SFIDAVE DHE ZGJIDHJEVE MË TË SHPESHTA

Personi përgjegjës për menaxhimin e procesit të pjesëmarrjes duhet të jetë i përgatitur të njoh sfidat e mundshme dhe të ketë disa opsione se si të merret me to. Në vijim, janë disa shembuj të sfidave më të shpeshta dhe ideve se si mund të adresohen ato.

□ *Buxheti për informim dhe konsultime është i vogël.*

Fokusohuni në shfrytëzimin e mënyrave ekzistuese të komunikimit: OJQ-ve lokale, TV dhe radios, internetit, mediave/rrjeteve sociale, posterave ose fletushkave. Përgatituni për t'iu përgjigjur pyetjeve kur është e nevojshme. Takimet e organizatave të tjera lokale mund të përdoren për prezantimin e informatave dhe marrjen e komenteve. Sidoqoftë, mos planifikoni ngjarje të mëdha të cilat kërkojnë fonde të konsiderueshme.

□ *Departamenti për Marrëdhënie me Publikun ose ndonjë organ tjetër në organizatën tuaj është përgjegjës për komunikimet.*

Qartësoni mesazhet para se të shtypet apo botohet diçka. Sigurohuni që keni marrëveshje të brendshme për përcjelljen e çfarëdo mesazhi. Qartësoni nëse departamenti për Marrëdhënie me Publikun ose ndonjë organ tjetër në organizatën tuaj do të jetë në gjendje t'i përpunojë informatat nga sondazhet/anketimet, të përgatisë një raport dhe t'iu përgjigjet komenteve.

□ *Nuk ka asnjë reagim nga audienca që ju jeni duke iu adresuar përmes aktiviteteve tuaja të informimit.*

Informacioni përfshin vetëm reagim të kufizuar, përveç nëse çështja bëhet kundërshtues dhe shkakton debat social. Megjithatë, me qëllim të testimit se si është përcjellë mesazhi juaj, ju mund të pyesni disa persona se çfarë kanë kuptuar nga komunikimi juaj për të parë nëse mesazhi juaj ka depërtuar siç duhet.

□ *Njerëzit nuk janë të kënaqur vetëm me nivelin e informimit.*

A kanë ata të drejtë se niveli i informimit nuk është i mjaftueshëm? A jeni në gjendje të ndryshoni nivelin e pjesëmarrjes? Nëse është e nevojshme, dërgojeni për diskutim tek autoritetet e nivelit më të lartë në organizatën tuaj. Është më lehtë të ndryshohet niveli i pjesëmarrjes më herët. Ngase, më vonë mund të bëhet më i vështirë mobilizimi i pjesëmarrësve, në qoftë se njerëzit tashmë janë zhgënjyer nga një përgjigje negative ndaj kërkesave të tyre.

□ *Nuk ka kohë për t'i bërë gjërat në mënyrë të duhur.*

Bëhuni real rreth afateve. Nëse nuk keni kohë të mjaftueshme për nivelet më të avancuara të pjesëmarrjes, ndaluni tek nivelet e ulëta, p.sh. konsultimi.

□ *Ju pranoni më tepër-ose më shumë reagime nga publiku nga ajo që keni planifikuar.*

Ndoshta konsultimi nuk ishte një nivel i duhur për angazhimin e personave? A ishte simuluar se si do të dukej nga pikëpamja e audiencës?

□ *Ju nuk jeni të sigurt nëse kolegët tuaj do të mbështesin vendimin tuaj për angazhimin e personave për marrjen e vendimeve së bashku në nivelet më të larta.*

Vendimet e tilla duhet të merren në fillim të procesit, me pëlqimin e plotë të menaxhmentit të organizatës. Nëse ka rezistencë si rezultat i mungesës së të kuptuarit, përfshini menaxhmentin në proces. Mbani punëtorin të brendshme para se t'i përfshini të tjerët.

□ *Njerëzit nuk kanë kureshtje për t'u bashkuar.*

Shpenzoni më shumë kohë më herët në organizim – bisedoni me individë të caktuar para mbajtjes së ndonjë tubimi. Gjeni se pse ata nuk janë të interesuar dhe çfarë do t'i bëjë ata më të vullnetshëm për t'u angazhuar.

❑ *Metodat të cilat duken të jenë tepër të komplikuar.*

Provoni disa metoda më të thjeshta me një grup të vogël që ju e njihni. Angazhoni një trajner apo organizator nga jashtë.

❑ *Që nga fillimi i diskutimeve, fokusohuni në përbërjen e komisioneve dhe grupeve, e jo në çështjen.*

Struktura e fundit duhet të vijë e fundit - pasi që keni zgjedhur atë që ju do të bëni, si të merrni mjetet, çfarë aftësi ju nevojiten dhe se si do të ndahen kompetencat dhe detyrimet, përcaktoni strukturat e përkohshme, si një grup drejtues me terma të qarta të referencës.

❑ *Konfliktet që dalin nga takimet e grupit drejtues.*

Investoni më shumë në sesionet e punëtorive dhe tubimet e rastit për të krijuar vizion të paanshëm dhe të kuptuarit e përbashkët.

❑ *Disa akterë/palë të interesit ndihen të lënë anash.*

Sqaroni se kush janë akterët dhe cilat janë interesat e tyre të vërteta. Edhe një herë, organizoni punëtorin në vend të formave tjera të pjesëmarrjes. Angazhoni një lehtësues/fasilitator të pavarur, p.sh. dikë prej shoqatave të lagjes apo më mirë, shfrytëzoni burimet njerëzore që i keni nga brenda, nëse janë në dispozicion.

❑ *Grupet e komunitetit mendojnë se është vështirë të organizohen.*

Ofroni ndihmë dhe udhëzime themelore. Lehtësoni/asistoni vizitat tek projektet e krahasueshme diku tjetër. Trajtojeni zhvillimin e individëve sikurse zhvillimin e projektit.

❑ *Grupi drejtues apo organi tjetër nuk mund të vendosë.*

Aranzhoni sesione të punëtorive jashtë grupeve formale këshilluese.

❑ *Aktivitete të vogla ndërmjet takimeve*

Përfundojeni çdo takim me një sesion të një aktiviteti. Nëse fondet mundësojnë, zgjedhni dikë për të organizuar aktivitetin. Qëndroni në kontakt, p.sh.përmes shkëmbimit të e-mailave apo buletinëve.

❑ *Grupet e komunitetit/akterët janë të gatshëm të angazhohen apo të veprojnë, por bartësit e mjeteve financiare këtë nuk ua mundësojnë.*

Organizoni sesione interne për të rritur përkushtimin brenda asociacioneve përkrahëse, aranzhoni takim me bartësit e mjeteve financiare. Shfrytëzoni mediet.

Përvoja e parë në mobilizimin e pjesëmarrjes së publikut fillimisht mund të jetë më e komplikuar se sa që duket, mirëpo gjithashtu ofron një mundësi të shkëlqyer për të mësuar dhe marrë përgjegjësi për të si dhe për rezultate dhe zbatim më të mirë të cilido projekt. Prandaj, provojeni dhe me fat!

## V. REFERENCAT:

1. Inclusive and Sustainable Urban Planning: A Guide for Municipalities, UN-Habitat publication, 2007, në dispozicion në ueb-faqen e UN-Habitat-it <http://unhabitat.org/publications/>
2. Public Participation Training Module , Regional Environmental Centre, në dispozicion në ueb-faqen e REC-ut [www.rec.org/training](http://www.rec.org/training)
3. Manual mbi pjesëmarrjen e komunitetit në rregullimin e vendbanimeve joformale, publikim i MMPH-së, 2013
4. Guide to Effective Participation, David Wilcox, në dispozicion në ueb-faqen [www.partnerships.org.uk/guide](http://www.partnerships.org.uk/guide)
5. A Ladder of Citizen Participation, article by Lithgow-Schmidt, në dispozicion në ueb-faqen [www.lithgow-schmidt.dk/Sherry Arnstein](http://www.lithgow-schmidt.dk/Sherry_Arnstein)
6. Template for Developing Guidelines on Public Participation, Public Service Commission of South Africa, 2010, në dispozicion në ueb-faqen <http://www.psc.gov.za/documents/docs/guidelines/Temp%20Develop%20Guide.pdf>
7. European Handbook for Participation, The Urbact Partecipando Network, në dispozicion në ueb-faqen [http://www.eukn.org/Policy\\_Labs/Public\\_Participation\\_in\\_the\\_Development\\_Process\\_9th\\_December\\_2013\\_Nicosia](http://www.eukn.org/Policy_Labs/Public_Participation_in_the_Development_Process_9th_December_2013_Nicosia)

Dokumente shtesë:

7. Public Participation in Post-Communist Societies: How can community involvement in urban planning be improved, a paper by Gheorge Multescu
8. Dare we jump off Arnstein's Ladder, a paper by Kevin Collins and Ray Ison, në dispozicion në: [programm.corp.at/cdrom2009/papers200/CORP2009\\_31](http://programm.corp.at/cdrom2009/papers200/CORP2009_31)
9. Vizionimi si mjet i planifikimit pjesëmarrës. Të mësuarit nga përvojat e Kosovës, publikim i UN-Habitat-it, 2012, në dispozicion në ueb-faqen e UN-Habitat-it <http://unhabitat.org/publications/>
10. Public participation in urban planning and strategies, lessons from medium sized cities in the Baltic Sea Region, by Samuli Lehtonen, në dispozicion në: [www.MECIBS.dk](http://www.MECIBS.dk)

SHTOJCA I. NIVELET E PJESËMARRJES PUBLIKE

Niveli i pjesëmarrjes	Koncepti	Aplikiminë procesin e planifikimit hapësinor	Format e angazhimit
Informimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qytetarët janë të informuar për të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre</li> <li>• Komunikimi njëanshëm, edhe në qoftë se informacioni është dhënë në bazë të kërkesës së akterëve</li> <li>• Nuk ofron mundësi për të dhënë komente ose për të hyrë në negociata</li> <li>• Informacioni përcillet nëpërmjet kanaleve që janë të arritshme për të gjithë anëtarët e komunitetit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Informacioni rreth planifikimit hapësinor shkëmbehet me akterët kyç të identifikuar</li> <li>• Fushata kryesore informuese mbahet para ngjarjeve të konsultimit, debateve publike dhe shqyrtimit publik</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njoftimet përmeshtypit, radios dhe TV-së,</li> <li>• Tabelat informative nëpër institucionedhe qytet</li> <li>• Posterat</li> <li>• Fletushkat dhe buletinët</li> <li>• Publikimet në ueb-faqe</li> <li>• Ditët e hapura në komuna dhe ministri</li> </ul>
Konsultimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komunikim i dyanshëm, ku akterët kanë mundësi të shprehin sugjerimet dhe shqetësimet</li> <li>• Nuk ofron asnjë siguri se idetë dhe opinionet e akterëve do të përdoren/mirren parasysh apo ashtu siç kanë synuar ata</li> <li>• Zakonisht realizohet nëpërmjet takimeve të kryesura nga një person që përfaqëson nivele të ndryshme të qeverisjes apo organeve të tyre, dëgjimeve publike (debateve) dhe anketimeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konsultimet janë element kyç në procesin e hartimit të planeve.Konsultimi fokusohet në zhvillimin e vizionit, misionit, qëllimeve dhe objektivave të përbashkëta përmes diskutimeve plenare, grupeve punuese, dhe takimeve tematike</li> <li>• Para finalizimit të planeve (gjatë shqyrtimit publik, siç parashihet me Udhëzimin Administrativ Nr.05 / 2014).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Anketimet,, pyetësorët, sondazhet e opinionit</li> <li>• Mbledhjet e kuvendit komunal</li> <li>• Debatet publike dhe shqyrtimetpublike</li> <li>• Takimet konsultative/diskutimet publike</li> <li>• Simulimet ku mundësitë dhe kufizimet janë të qarta.</li> </ul> <p>Këto metoda/forma mund të përdoren në lidhje me dhënien e informacionit dhe teknikat prezantuese, për shembull:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Reklamat.</li> <li>• Konferencë për media.</li> <li>• Fletushkat dhe posterat.</li> <li>• Ekspozitat.</li> <li>• Ueb-faqet</li> <li>• Rrjetet/mediet sociale</li> <li>• Videot.</li> <li>• Ofroni qasje direkte publike për të parë dhe komentuar të dhënat, hartat, grafikonet dhe të gjitha planet përpalët e interesuara.</li> </ul>

Niveli i pjesëmarrjes	Koncepti	Aplikiminë procesin e planifikimit hapësinor	Format e angazhimit
Ndërtimi i konsensusit/Marrja e vendimeve së bashku	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëveprimi i palëvetë interesit në mënyrë që të kuptojnë njëri-tjetrin dhe të arrijnë në qëndrime të negociuara që janë të pranueshme për tërë grupin</li> <li>• Sidoqoftë, individët dhe grupet e cenueshme/të marginalizuara shpesh synojnë të heshtin apo të pajtohen në mënyrë pasive për zgjidhjen e negociuar</li> <li>• Zbatimi i strategjive që sigurojnë se opinionet e burrave dhe grave konsiderohen në mënyrë të barabartë, sidomos në këtë fazë</li> <li>• Paraqitja e kompetencave/fuqisë dhe e përgjegjësive për rezultatet që mund të pasojnë.</li> <li>• Negociatat në këtë fazë reflektojnë shkallë të ndryshme të angazhimit të ushtruar nga individët dhe grupet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfshirja në konsultime për planifikimin hapësinor, në grupe pjesëmarrëse, iu mundëson palëve të interesit që të marrin pjesë në vendimmarrje për të ardhmen e qytetit dhe shfrytëzimin e burimeve të tij njerëzore, natyrore dhe financiare drejt zbatimit/realizimit të vizionit të qytetit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Metodatat e informimit për të filluar procesin;</li> <li>• Sondazhet/anketimet online, p.sh. votimi për përcaktimin e prioriteteve strategjike;</li> <li>• Debatet e hapura, punëtoritë, takimet ballë për ballë;</li> <li>• Analiza SWOT për të kuptuar se ku qëndroni;</li> <li>• Shkëmbimi i ideve, sondazhet/anketimet për të zhvilluar disa opsione;</li> <li>• Punëtoritë e Vizionimit - Metodatat për të vendosur së bashku për krijimin e një vizioni të përbashkët<sup>2</sup>.</li> <li>• Punëtori për planifikimin e veprimeve.</li> </ul>


<sup>2</sup>Shih: "Vizionimi si mjet i planifikimit pjesëmarrës. Të mësuarit nga përvoja e Kosovës"

Niveli i pjesëmarrjes	Koncepti	Aplikiminë procesin e planifikimit hapësinor	Format e angazhimit
Të vepruarit së bashku	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Veprimet kolektive të cilat rezultojnë me një kombinim të pasojave përfituese, të dëmshme dhe neutrale të cilat ndahen në mënyrë të barabartë nga të gjithë partnerët/palët e interesit;</li> <li>• Llogaridhënia është themelore në këtë fazë;</li> <li>• Shkëmbimi në mes të akterëve me status të ngjashëm, të barabartë dhe drejt një qëllimi të përbashkët</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Planifikimi hapësinor rezulton në një shkallë të ndarjes së përfitimeve dhe rreziqeve të mundshme në mes të akterëve/palëve të interesit, por përpiqet të zbusë rrezikun nëpërmjet ndërtimit të konsensusit dhe analizës së projekteve zhvillimore në aspektin e ndikimit të tyre financiar, socio-ekonomik dhe ekologjik;</li> <li>• Vendosja e partneriteteve publiko-private për ofrimin e shërbimeve, mirëmbajtjen e ndërtesave të banimit, etj, është një nga mënyrat për të rritur efikasitetin dhe/apo koston-efektivitetin të qeverisjes lokale;</li> <li>• Qytetarët dhe akterët tjerë janë të angazhuar në zbatimin e planeve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Metodatat e informimit për të filluar procesin;</li> <li>• Ushtrimet për ndërtimin e ekipit;</li> <li>• Ushtrimet e dizajnit;</li> <li>• Ushtrimet e planifikimit të biznesit;</li> <li>• Strukturat e përkohshme si palët punuese dhe grupet drejtuese si fokus për vendimmarrje dhe llogaridhënie.</li> </ul>
Mbështetja e iniciativave lokale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Niveli më i lartë i përpjekjeve të pjesëmarrjes</li> <li>• Akterët/palët e interesit e marrin përgjegjësinë e plotë për projektet që kanë ndikim tek ata drejtpërsëdrejti dhe janë të gatshëm për të mësuar se si të realizojnë procesin nga fillimi deri në fund.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Formë e pjesëmarrjes që mund të aplikohet në zbatimin e planit të veprimit, sidomos për projektet të lagjeve ose të atyre të nivelit të komunitetit;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Punëtoritë për të ndihmuar grupet e komunitetit në krijimin e një vizioni të përbashkët dhe planifikimeve veprimeve të tyre;</li> <li>• Ushtrimet për ndërtimin e ekipit;</li> <li>• Planifikimi i angazhimit;</li> <li>• Ushtrimet e planifikimit të biznesit;</li> <li>• Punëtoritë për projektim, ngritje të fondeve dhe publicitet;</li> <li>• Vizitat në projekte të ngjashme;</li> <li>• Strukturat e përkohshme si palët punuese dhe grupet drejtuese si një fokus</li> </ul>

Niveli i pjesëmarrjes	Koncepti	Aplikiminë procesin e planifikimit hapësinor	Format e angazhimit
			<p>për vendimmarrje dhe llogaridhënie.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Strukturat afatgjata, kur interesat e komunitetit janë të përfaqësuara denjësisht</li> </ul>




SHTOJCA II. SHEMBULL: KORNIZA KOHORE E KONSULTIMEVE PËR PLANIN HAPËSINOR



SHTOJCA III. SHEMBULL I: MATRICA E STRUKTURËS SË NDARJES SË PUNËS PËR ORGANIZIMIN E DISKUTIMIT PUBLIK

- Identifikoni aktivitetet dhe gruponi ato në faza
- Krijoni një strukturë të duhur për të përcjellur mbarëvajtjen e aktiviteteve
- Bazë e mirë për dakordim në mes të menaxherit të projektit dhe anëtarëve të grupit



\*Sigurohuni që të gjitha outputet relevante, si broshurat, agjendat, prezantimet ftesat, posterat, etj., të përkthehen në gjuhët përkatëse të aplikueshme!

SHTOJCA IV. SHEMBULL: SHABLLONI I MATRICËS SË AKTIVITETIT/PËRGJEGJËSIVE

- Bëni një listë të të gjitha aktiviteteve që rrjedhin nga struktura e punës
- Përdorni matricën si një mjet për të arritur përkushtimin dhe përgjegjësinë që kërkohet për të arritur zbatimin e duhur të Planit

PP Nr.	Paketa e punës	Përgjegjës	Afati i fundit	Të përfunduara/Të papërfunduara
1.1	DIZAJNONI BALLINËN E CD-së	Z	DD/MM/VV	-
1.2	REGJISTRONI CD-të	Y	DD/MM/VV	+
2.1	PËRGATISNI TEKSTIN	X	DD/MM/VV	-
2.3	PËRZGJEDHNI FOTOGRAFITË	X	DD/MM/VV	+
2.4	DIZAJNONI BROSHURËN	Y	DD/MM/VV	-
2.5	SHTYPNI BROSHURAT	X	DD/MM/VV	-
3.1	PËRGATITNI PREZANTIMIN	Z	DD/MM/VV	-
3.2	TESTONI/SHQYRTONI PREZANTIMIN	Y	DD/MM/VV	-
3.3	PËRGATITUNI PËR TË NXITUR DEBATIN	X	DD/MM/VV	+
	...	...	...	...
	...			

## SHTOJCA V. SHEMBULL I PYETËSORIT TË VLERËSIMIT

Ju lutem jepni përgjigjet tuaja në kuti sa i përket vlerësimit, duke përdorur 1 si shumë negative dhe 5 si shumë pozitive në secilën nga pyetjet. Nëse përgjigjja juaj është 1 ose 2 ju lutem ofroni komentet/sugjerimet tuaja për përmirësimet e mundshme.

Ky pyetësor është anonim dhe do të përdoret vetëm për qëllime të organizatorëve.

Shumë negative 

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

 Shumë pozitive

Pyetjet	1	2	3	4	5	Komentet/sugjerimet
1. Në përgjithësi, si e vlerësoni punëtorinë?						
2. Si e vlerësoni përmbajtjen e punëtorisë në lidhje me arritjen e qëllimeve të punëtorisë?						
3. Si e vlerësoni përmbajtjen e prezantimeve dhe prezantuesit? Ju lutem komentoni rreth çfarëdo preference tuajën sa i përket prezantimit/prezantuesve.						
4. Si i vlerësoni mësimet e nxjerra/rekomandimet nga punëtorja? A do t'iu ndihmoj informacioni i marrë në punëtori në punën tuaj?						
5. Si e vlerësoni moderimin?						
6. Si e vlerësoni teknikën-logjistikën (ushqimin, sallën e konferencës, përkthimin)?						

Shkruani ndonjë koment shtesë që është i rëndësishëm për punëtoritë në të ardhmen, përfshirë temat që do të mund të trajtoheshin.

